

Fadil Curri

POEZI ME IDE E BUKURI MALLI

Besim Xhelili: "Mes luleve dhe lotit" (poezi),

Poeti Besim Xhelili në librin e tij më të ri "Mes luleve dhe lotit" na vjen me hapërim shumë më madhështor se në librat paraprakë, në të cilat frymëzimi përshkohej nga fabula deklarative e përjetimeve. Këtë herë autori përfutet në qëmtimin e temave më të guximshme, më të ndjeshme dhe më madhore e që kërkojnë delabirintizime historike, aktuale e perspektive. Trikohësia e mallit dhe e krenarisë kolektive në sheshin poetik shfaqet si kundrim autorial tejet relaksues, herë si mall për të shkuarën e zhbërë nga, herë me krenarinë e shpëtuar, herë me platformë rivitalizuese të krenarisë kombëtare. Të shkuarën e ka frymëzim në ciklin "...ethe Atdheu".

Koshient për padrejtësitë e bëra popujve të vegjël nëpër konferencat vendimmarrëse gjatë historisë nga ana e popujve të mëdhenj, autori është kundër hartave të skicuara me imponim e levërdi të njëanshme, ndaj edhe me bashkëbisedë të poetizuar porosit të grisen hartat, sepse në to nuk janë pajonët, dalmatët e dardanët e tretur dhe i vetmi ngushëllim do të ishte bashkimi i dashurive dhe tokave shqiptare në një Shqipëri të bashkuar të Evropës së po të këtillë. Vendin e tij historik e aktual, kuptohet me syrin perspektiv, poeti sikur e prindëron me ATDHE e MËMËDHE. Shtati i tij nuk është si i paracaktuar nga armiqtë, por që flitet nga një abetare civilizuese, çelës i shprehjes së dëshirave në Tetovë, Shkup, Preshevë, Ulqin e Janinë, pra edhe në atë shtrat ku gjenden gjymtyrët e tij jashtë jorganit. Kundër hartës së shtatit është autori, duke kujtuar se edhe Tetovën Perëndia e la këtu ku është, si ishte ilirike.

Në këto poezi harta e gëzimit të atdheut nuk është e tkurrur sipas qejfit të të huajve, por shtrihet sipas dëshirës reale të banuesve të saj dhe në gëzime hedhin valle për shtetbërjen bashkërisht, kudo ku flitet shqipja.

*Atje sot flamujt valojnë
Kuç e zi është bërë rruga
Nga Tirana në Prishtinë
Shkupi, Tetova deri te Struga.*

*Nga Malësia deri në Shkodër
Hidhet vallja e shqipeve me lodër
N' Mitrovicë e Preshevë pushkët krisin
Dhe në Prizren vallen e nisin.*

Grisësve të hartave vetanake u fshikullon kamçikun poetik autori, herë me stigmatizimin fabulativ në Teatrin e kafshëve e të katilëve, përbindëshave, qenve të tërbuar, ujqve e ardhacakëve që duan t'ua përdhosin pasurinë lëndore e shpirtërore vendësve. Heshtja ndaj këtyre dramave ndjella-keqe është temë përzgjimi për poetin, sa nuk është bërë vonë. Këto mbrapshti sjellin edhe tmerrin e jetës mjerane, sa edhe Migjenin e kërkon të jetë krah i lëmoshëtarëve të pakrahë.

Në këtë cikël frymëzimesh mes mallit e krenarisë, mes të dukshmes shpresëdhënëse e të padukshmes së zhbërë, janë edhe konturat e shpirtit të pathyer, të pezmatuar dhe që meriton rindërtimin e tij. Fjalët Atdheu e Flamur janë të përveçme dhe shkruhen me germa të mëdha, ndaj në këtë nuk ndikojnë as edhe ndasitë fetare që përpiqen të bëjnë ndaj myslimanëve e katolikëve përçarësit e shqiptarisë, e cila e flet një gjuhë që e trashëgon një shpirt të përbashkët me histori shumëfetare.

Një botë tejet intime e përshkon ciklin e dytë të përmbledhjes së poezisë “mes luleve dhe lotit”. Ndjenja e dashurisë në vargje kundrohet me realitet dhe asnjësi, por me intimitet të thjeshtë sipas lakmisë së singertë. Idila dashurore vjen në trajta të kujtimeve me ide të këndshme, që paksa mund të ketë edhe ndikime folklorike, si është dalja me fustan shkallëve.

Vendlindjen këtu e identifikon me “atje poshtë”, kundruar vendin ku ndodhet personazhi krijues në kurbet. Në “atje poshtë” nxjerrin dritë edhe besëtytnitë për mbulesën e bukurisë, që të mos shëmtohet nga syri i huaj. Dashuria platonike është asgjë karshi dashurisë substanciale, të qenshmes. Flijimi bëhet edhe në përpjekjet për regjisor, njëësor, shkrimtar e qyqe të jetë pranë saj prore.

Nuk mungojnë përshkrimet figurative, metaforizimet e ngjarjeve të përjetuara, kur paraburgim identifikohet çasti i puthjes. Dashuria është derë e lumturisë, ndaj edhe nuk është ligësi nëse ka dhembje zemre nga mungesa e saj. Ndjenja e dashurisë lundron inspirativisht nga poeti nëpër stinë e ditënatë, trazime shpirtërore herë të gëzueshme e herë dëshpëruese, herë shpresëhumbur e herë kurajues. Poezia do realizimin faktik të shpirtësisë dashurore.

*Mos u pafshim në atë botë
Nëse këtu sot ma pi gjakun!*

Pastaj po në të njëjtën poezi sikur do të klithë dëshpërueshëm:

*Mos u pafshim në atë botë
Edhe nëse duan të na falin!
Mos u pafshim në atë botë
Edhe nëse duan të na shndërrojnë ne engjëj!*

Ndryshe, si dashuri e vdekur, nuk e do as në parajsë, as në çastin e gjykimit në tjetërbotë. Me gjithë rëniengritjet dashurore, poeti prore e vë në vijimësi jetën, vetëkurajimin dhe rikrijimin. Pra, porosia vargëruese është që e bukura dhe dashuria është e frytshme në të gjallë, kur edhe është krijuar të shërbejë si erë e lehtë që i ledhaton e freskon krahët e zogut, si e thotë në një poezi. Dashuria është lumturi, është ringjallje, shpëtim e strehim.

Interesant është edhe cikli i fundit “Përmallim”, në të cilin kryekeje ka kronika të poetizuara të mallit e të kujtimeve për vendlindjen e atdheun. Dendur vehet në qarkullim figura e personifikimit, herë si erë e herë si dallëndyshe, por i mberthyer nga malli e kujtimi. Na kujton këtu dallëndyshen e Filip Shirokës që e dërgon nga kurbeti në Shkodër, bukoliken e Naim Frashërit për vendet e bukura të maleve e fushave të Shqipërisë.

Malli është emblemë e frymëzimit e hapërimit poetik edhe kur personifikon me dallëndyshet:

*Ju e dini sa larg kam shkuar
Shumë herë me veten për ju flas,
Jo, jo juve nuk ju kam harruar
Shpirti më qan, zemra më plas.
Ose,*

*Atje ku ju keni ndërtuar folenë
Ku më ngroh një ndjenjë e pafund,
Atje me ju dua të ndaj harenë
Dallëndyshet e mia, ju shoh gjithkund.*

E lut erën që ta marrë e ta kthejë në vendlindjen e tij, ku do të përqafojë nënën e babanë, të shohë shkollarët si shkojnë në shkollë, të rishohë zogjtë që i mungojnë reciprokisht, të

endet nëpër luadhet, duke e kujtuar çapkënllekun fëmijëror duke vjedhur specat e domate.

Ndër poezitë më të bukura të këtij cikli, mbase edhe tërë librit është “Dallëndyshet e mia”, në të cilën derdhet i tërë shpirti përmallues i një mërgimtari. Këtu del premtimi se shmangia nga atdheu është relative, sepse pleqërinë pandeh ta ketë atje, si do të thoshte Çajupi “ku i duket balta më e bukur se mjalta”.

Edhe këtë cikël e përshkon pikëllimi, sidomos për shokët e vdekur, me të cilët i lidh kujtimi i jetës së shkuar me ta në fëmijëri e rini, sportimet e miqësimet e pahile, malli për mësuesin dhe Përshefcën e tij të dashur, vendlindjen e paharrueshme, dhe që është krenar që nga ajo doli. E konsideron të djeshmen, të sotmen e të nesërmen, nënë e baba, veten e ndjen të madh e të fortë sa një mal, dashuri e zhgënjim, shpresë e rimëkëmbje.

Përgjithësisht shikuar, libri “Mes luleve dhe lotit” i Besim Xhelilit sjell freski letrare ndër lexuesit. Karakterizohet me pjekuri të përparuar nga veprimtaria e deritashme letrare dhe komunikon me poezinë frymëzimisht e fugurativisht shumë këndshëm.

Idetë e autorit për çështjet historike kombëtare e jo vetëm kaq, për fatet e ndërlikuara me padashje nga ai, janë tejet të çiltra e të guximshme. Vërehet edhe një përparim i mbarështimit poetik, tejet i këndshëm për lexuesit.

Fadil Curri
Recensent
Shkup, maj 2013